

Nr. 208 / Prot. 7

Tiranë, më 18.02.2019

URDHËR I BRENDSHËM

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", si edhe bazuar në sugjerimet e Bordit Drejtues, sipas procesverbalit me nr. Prot. 208 / Datë 15.02.2019:
13

URDHËROJ

1. Miratimin e ngritjes së Komitetit të Konfidencialitetit me përbërjen si vijon:

- a) Kryetar- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor
- b) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të dhënave
- c) Anëtar – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit
- d) Sekretar- Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Bazave të të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata

2. Qëllimi i ngritjes së KK

Qëllimi i ngritjes së KK është garantimi i parimit të konfidencialitetit statistikor nëpërmjet marrjes së masave parandaluese për sigurimin e konfidencialitetit statistikor gjatë proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave zyrtare, si dhe ndalimin e përdorimit të të dhënave për qëllime jostatistikore. Të miratojë listën e software-ve që do të instalohen në kompjuterat e "Dhomës së sigurt".

3. Objekti i KK

3.1 Objekti i KK do të jetë kontrolli i udhëzimeve/rregulloreve të brendshme për Konfidencialitetin statistikor që janë ndjekur nga stafi i INSTAT;

3.2 Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive që do të ketë personeli i INSTAT për të mbrojtjen e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt ose indirekt për qëllime statistikore nga burime administrative ose të tjera;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

4. Mbledhja e KK

4.1 KK mbledhet të paktën dy herë në vit për të shqyrtuar procedurat dhe infrastrukturën e administrimit të të dhënave të mbledhura për qëllime statistikore si dhe në raste të tjera që kanë nevojë reagimin e KK ndaj zhvillimeve dhe kërcënimeve të konfidencialitetit statistikor.

4.2 Kur KK e gjykon të nevojshme, mban minutat e takimit për çështje të cilat kanë nevojë për tu diskutuar dhe vendosur me Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT.

5. Vendimmarrja

5.1 KK i merr vendimet e tij me shumicë të thjeshtë. Anëtari që është kundër vendimit, është i detyruar të argumentojë votën e tij kundër.

5.2 Vendimet e KK zbardhen dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët brenda 3 ditëve nga data e zhvillimit të mbledhjeve.

6. Të drejta dhe detyra të KK

6.1 KK e ushtron veprimtarinë e tij duke u bazuar në mirëbesim dhe duke u udhëhequr nga parimet e etikës profesionale për të krijuar një vlerë të shtuar infrastrukturore për institucionin publik INSTAT.

6.2 Për ushtrimin e funksionit të tij, KK ka të drejtë të kërkojë nga GTK informacion të detajuar si dhe të thërrasë për ndihmë specialistë të tjerë të INSTAT-it.

6.3 Për çdo rast të parashikuar sipas pikës 6.2, KK përdor komunikimet me e-mailin zyrtar dhe vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT.

6.4 KK diskuton me drejtorët e drejtorive të tjera të INSTAT projekt-udhëzimet e Konfidencialitetit për çështje të caktuara dhe në tërësinë e tyre.

6.5 Nëse ka komente dhe sugjerime nga drejtoritë e INSTAT sipas pikës 6.4 të këtij Urdhëri, KK kryen rregullimet e mundshme brenda 5 ditëve nga marrja e mendimeve.

6.6 KK mund të mos marrë parasysh sugjerimet nëse i konsideron si të paargumentuara dhe/ose të panevojshme.

6.7 Kryetari i KK koordinon punën e grupit.

6.8 KK vendos për versionet standard të software-ve që do të instalohen në kompjuterat e "Dhomës së sigurt".

6.9 KK diskuton anonimizimin e mikrodateve dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave tabulare;

6.10 KK propozon veprime përmirësuese për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm;

6.12 Monitoron zbatimin e planeve përmirësuese nëpërmjet planit të ardhshëm operativ.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300 www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Afati i përmbushjes së detyrave të KK

7.1 KK e ushtron aktivitetin gjatë gjithë kohës që është në fuqi ky Urdhër.

8. Hyrja në fuqi

8.1 Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm.

DELINA IBRAHIMAJ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: Helda Mitre Drejtore e drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300 www.instat.gov.al